



Funded by
the European Union



Budget
Accountability
and Transparency

TERMAT E REFERENCËS

Ekspertë për #BATproject

TITULLI I PROJEKTIT	Kapacitete për Mbikëqyrje Qytetare të Llogaridhënies dhe Transparencës Buxhetore: BAT-Civil Society
ORGANIZATAT ZBATUESE	Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), Qendra për Hulumtim dhe Politikëbërje (CRPM), Faktoje
DONATORI	European Commission
REF. NR.	EuropeAid/174080/DD/ACT/
POZICIONI	Ekspert për hartimin e dokumenteve të politikave
PERIUDHA E ZBATIMIT	Shkurt 2025 – Qershor 2025

INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, në bashkëpunim me Qendrën për Hulumtim dhe Politikëbërje (CRPM) dhe Faktoje, po zbaton projektin “Kapacitetet për mbikëqyrje qytetare të Llogaridhënies dhe Transparencës Buxhetore: *BAT-Civil Society*”, i financuar nga Bashkimi Evropian.

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti është përmirësimi i qeverisjes dhe mbikëqyrjes së transparencës dhe llogaridhënies buxhetore duke forcuar kapacitetet e OSHC-ve në nivel lokal dhe kombëtar për të marrë pjesë në mënyrë efektive në planifikimin e buxhetit dhe për të monitoruar dhe vlerësuar zbatimin e tij. Në veçanti, projekti synon të tejkalojë pengesat në mbikëqyrjen nga shoqëria civile duke fuqizuar kapacitetet e tyre dhe duke mbështetur përpjekjet për të rritur transparencën buxhetore.

Gjithashtu, projekti synon përmirësimin e politikave dhe praktikave ekzistuese të institucioneve shtetërore në nivel qendror dhe lokal për planifikimin, zbatimin dhe raportimin e buxhetit, duke rritur mbikëqyrjen publike

QËLLIMI & REZULTATET E PRITURA

Komponenti i politikave i #BATproject synon të hartojë alternativa dhe instrumente politikash që ndikojnë në mënyrë të qëndrueshme duke përmirësuar jo vetëm kuadrin, por edhe qasjen dhe praktikën e punës së aktorëve të synuar.

Në këtë kuadër, **objektivi** i kësaj thirrjeje është rekrutimi i një grupi ekspertësh për të hartuar një seri dokumentesh të politikave për përmirësimin e llogaridhënies buxhetore, transparencës, pjesëmarrjes, integritetit dhe çështjeve të ndërlidhura ndërsektoriale (p.sh. buxhetimi gjinor) në nivel lokal dhe qendror, si dhe për forcimin e roleve të organeve mbikëqyrëse dhe aktorëve qytetarë.

Dokumentet e politikave do të hartohen në bashkëpunim me ekipin e projektit dhe do të konsultohen me aktorët e projektit, si përfituesit e nën-granteve të BAT dhe institucionet e synuara.

IDM synon të angazhojë deri në **pesë** ekspertë.

FUSHËVEPRIMI

Ekspertët e angazhuar do të kenë për detyrë:

- Të marrin pjesë në takime përgatitore me ekipin e projektit për të diskutuar qasjen e punës, për të qartësuar pritshmëritë, për të ofruar udhëzime dhe për të rënë dakord mbi afatet.
- Bazuar në marrëveshjen me ekipin e projektit, të hartojnë një dokument politikash mbi temën e përcaktuar, duke ndjekur modelin dhe udhëzimet e ofruara, dhe ta dorëzojnë për shqyrtim ekipit të projektit.
- Të finalizojnë dokumentin e politikave dhe ta dorëzojnë në formë të gatshme për publikim.
- Të marrin pjesë dhe të prezantojnë dokumentin e politikave në punëtoritë e organizuara nga IDM

PAGESA DHE KOHËZGJATJA

Pagesa për këtë pozicion është EUR 2,700/ekspert (bruto). Pagesa do të kryhet në tre këste sipas parashikimeve të përfshira në kontratën e shërbimit. Ekspertët pritet të jenë të angazhuar gjatë periudhës Shkurt 2025 – Qershor 2025.

KRITERET

- Diplomë në shkencat politike, financat publike, drejtësi ose fusha të tjera relevante.
- Ekspertizë në përputhje me fushën dhe detyrat e përshkruara në termat e referencës.
- Preferohen 7 vite përvojë në proceset e politikëbërjes, por kërkohen minimumi 5 vite.
- Përvojë e mëparshme në projekte ose detyra që lidhen me proceset e planifikimit buxhetor, mbikëqyrjen dhe transparencën buxhetore, ose mirëqeverisjen.
- Aftësi të forta analitike, kërkimore dhe interpretimi të të dhënave, me aftësinë për t'i përkthyer gjetjet në rekomandime praktike.
- Përvojë në hartimin e raporteve dhe materialeve komunikimi për politikëbërësit, aktorët e interesuar dhe publikun e gjerë.
- Aftësi të shkëlqyera komunikuese dhe shkruese në gjuhën shqipe dhe angleze, me aftësinë për të paraqitur informacion kompleks në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme.